

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
MINISTRIE E INFRASTRUKTURËS DHE TRANSPORTIT	
MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE I TRANSPORTA	
MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND TRANSPORTATION	
Numri i Protokollit: 04	Numri i Protokollit: 224
Organi i Emrit: 3	Data: 10.01.20
PRISHTINE/A	

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transport

Departamenti i Transportit Rrugor


DATË/A:	09.01.2020
REFERENC-Ë:	0311005
PËR/ZA/TO:	Shoqatat e Operatorëve të Transportit Rrugor të udhëtarëve me Autobus
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z.Betim Reçica-Sekretar i Përgjithshëm
NGA/OD/FROM:	Xheme Veseli – Drejtor i DTT-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Lajmërim

Lajmerohen të gjithë operatorët e transportit ndër-urban të licencuar nga MIT, se bazuar në Ligjin për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179; U.A Nr. 09/2013 dhe U.A Nr.06/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e U.A 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin ndër-urban të udhëtarëve me autobus, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, do bëjë Vazhdimin dhe Vërtetimin e Rendeve të Udhëtimit.

I tërë dokumentacioni për aplikim dhe informatat e nevojshme mund të merren në zyrë të shoqatave të operatoreve transportues nëpër regjione, si dhe në zyrë të MIT- (ish ndërtesa e Gërmisë, zyrë C-108 ose në Tel. 038 20028517 ; 038 20028046

Afati për Aplikim është prej datës ; 10.01.2020 deri me datën:31.01.2020 në ora 16.00

Me respekt



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transport

DEPARTAMENTI I TRANSPORTIT RRUGOR/SEKTOR DRUMSKOG SAOBRAĆAJA/ROAD
TRANSPORT DEPARTMENT

APLIKACION

PËR VAZHDIMIN DHE VËRTETIMIN E RENDEVE TË UDHËTIMIT

Operatori : _____, Selia

Licenca nr. _____ Komuna _____

e-mail: _____

Tel-fax: _____

Fletëpagesën 10.00 € , për çdo rend të udhëtimit

Relacioni: _____

	1	2	3	4	5
Nisja:	/ ___ /	/ ___ /	/ ___ /	/ ___ /	/ ___ /
Kthimi:	/ ___ /	/ ___ /	/ ___ /	/ ___ /	/ ___ /

Emri dhe mbiemri i menaxherit,
dhe nënshkrimi

Vula

data e aplikimit

Vërejtje:

Për te dhëna jo te sakta përgjigjet menaxheri i Operatorit Transportues.

PËRMBAJTJA E SHPALLJES PUBLIKE.

Shpallja publike për paraqitjen e aplikacioneve për Vazhdimin dhe Vërtetimin e Rendeve të Udhëtimit në transportin e rregullt publik të udhëtarëve në transportin nder urban :

KUSHTET PËR APLIKIM:

1. Aplikacionin dhe fletpagesën
2. Licencën për transport "C" ose "D" të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit për të cilën nuk është iniciuar ndonjë procedurë e pezullimit apo revokimit **(Kopje)**;
3. Certifikata e regjistrimit të bizneseve në Kosovë (komplet , përfshirë shifren e transportit rrugor të udhëtarëve) **(Kopje)**
4. Dëshmitë mbi Kompetencën Profesionale për menaxher të operatorit transportues **(CPC-Kopje)**
 - Menaxheri i operatorit të transportit rrugor nuk mund të paraqitet edhe si shofer për vertetim dhe vazhdim të rendit të udhëtimit;
5. Dëshminë për relacionin deri në 50 km së paku një (1) shofer për tri (3) rende të udhëtimit;
6. Dëshminë për relacionin mbi 50 km së paku një (1) shofer për dy (2) rende të udhëtimit;
 - Për situatën referuar pikës 4,5 dhe 6 ,kontratat e punës(origjinal ose kopje e noterizuar) ;patent shoferi-valid (kopje e noterizuar); vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit për të punësuarit (menaxheri;Shoferët), se të punësuarit në fjalë nuk janë delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit *[para datës së publikimit të këtij Njoftimi*
7. Dëshmitë për kapacitetet përkatëse të autobusëve të destinimit ndër urban të **certifikuar** nga MIT-ja(kopje) sipas licencës "C" apo "D" (librezat e qarkullimit, sigurimi dhe kartoni gjashtëmujor)-(kopje e noterizuar) valid ;
8. Rendin e udhëtimit në origjinal të vitit paraprak të vertetuar nga Ministria ,për të cilin nuk është iniciuar procedurë e revokimit;
9. Tri kopje të rendit të udhëtimit sipas formës dhe përmbajtjes së aprovuar nga Ministria;
 - Nëse operatori nuk plotëson kushtet për vazhdimin e rendit të udhëtimit , atëherë rendi i udhëtimit do të shpallet i lire ;
10. Me rastin e Aplikimit për vazhdimin dhe vërtetimin e rendit të udhëtimit operatori do të paguaj tarifën **10.00 € , për çdo rend të udhëtimit.**

MËNYRA E APLIKIMIT:

1. Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentacion sipas kushteve për aplikim duhet të dorëzohet në Arkivin e MIT-së Ish ndërtesa e Gërmisë nga data:
10.01.2020 deri me datën:31.01.2020 në ora 16.00
2. Operatori i Transportit duhet të vendosë dokumentacionin në një origjinal ose të noterizuar **në një zarf të vetëm** dhe në anën e përparme të zarfit do të:
 - Adresën e vendit të dorëzimit të Aplikacioneve
 - Shënon qartë si "**Origjinal**"
 - Shënon qartë " Qellimin e Aplikimit "
 - Shënon emrin dhe adresën e Operatorit të Transportit tenderuesit.
3. Informatat më të hollësishme merren në zyrën Nr.C109. Ish ndërtesa e Gërmisë.
Tel 038 20028517 · 038 20028046